KES|CO
KOMPANIA KOSOVARE PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE SH.A.
KOSOVO ELEKTRICITY SYPPLY COMPANY J.S.C.
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA SNABDEVANJE ELEKTRIČNOM ENERGIJOM D.D.
Ndërtesa e Elektrokosovës
Bulevardi Bill Klinton nr 3
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës

KESCO SH.A.
Nr. 03 Dt. 21.01.2020
HQ 1

Arsim Janova
ud. Kryesues i Bordit të ZRrE-së

Hasan Gokalp Cinbis
Drejtor Ekzekutiv Komercial,
KESCo sh.a

21 Janar 2020

LËNDA: PROPOZIM PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE PËR VITIN TARIFOR 2020

I nderuari z. Janova,

Aplikimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale është përgatitur nga KESCo në formë elektronike dhe në letër, duke respektuar afatin kohorë të përcaktuar në shtojcën 3 të Rregullës për Përcaktimin e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla e Çmimeve të FShU) dhe shkresës së ZRRE-së të lëshuar më 9 Dhjetor 2019.

KESCo mbetet i përkushtuar për bashkëpunim me qëllim që të arrihen konkluzione të përshtatshme të cilat janë në interesin e të gjitha palëve pjesëmarrëse në sektorin e energjisë.

Me respekt,

Hasan Gokalp Cinbis
Drejtor Ekzekutiv Komercial, KESCo Sh.a

KES|CO

Ndërtesa e Elektrokosovës Elektrokosova Building
Bulevardi Bill Klinton nr.3 Bill Clinton Bulevard no.3
Prishtinë 10000 Prishtina 10 000
Republika e Kosovës Republic of Kosovo

Aplikimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale në vitin 2020 për Furnizuesin me Shërbim Universal

Janar 2020

Ndërtesa e Elektrokosovës Elektrokosova Building
Bulevardi Bill Klinton nr.3 Bill Clinton Bulevard no.3
Prishtinë 10000 Prishtina 10 000
Republika e Kosovës Republic of Kosovo

Përmbajtja:

1. Hyrje 3
2. Bilanci i Energjisë Elektrike dhe Blerjet 4
3. Kostot me pakicë për vitin 2020 6
4. Kostot e blerjes së energjisë 8
   4.1. Kostoja e energjisë së blerë nga prodhimi vendor 8
   4.2. Kostot e Importit të Energjisë 10
   4.3. Parametrat hyrëse 10
   4.4. Përcaktimi i Kostove të Blerjes me Shumicë për vitin 2020 11
5. Kostot e bartshme për vitin përkatës t 12
6. Kostot e kapitalit punues dhe kompensimi për borxhin e keq në vitin relevant t 13
   6.1. Kostot e kapitalit punues 13
   6.2. Borxhi i keq 13
7. Përshtatjet dhe faktori korrigjues i të hyrave për vitin relevant t 15
8. Përcaktimi i MAR për vitin relevant t 16

1. Hyrje

Në përputhje me Shtojcën 3 të Rregullës për Vendosjen e të hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU) dhe shkresës së ZRRE-së të lëshuar më 9 dhjetor 2019, KESCO si subjekt i licencuar nga Rregullatori për të kryer Furnizimin me Shërbim Universal ka përgatitur aplikimin për të hyrat e lejuara maksimale (MAR) për vitin 2020.

Në pajtim me Rregullën për të Hyrat e FSHU-së, ky aplikim paraqet parashikimin e të dhënave teknike dhe financiare për blerjet e energjisë nga prodhimi vendor dhe importi, përkatësisht blerjet me shumicë të energjisë, shpenzimet operative, shpenzimet e bartshme dhe përshtatjet për vitet e mëparshme.

Duhet theksuar se ZRRE nuk ka hapur procesin e shqyrtimit dhe nuk ka aprovuar parametrat hyrëse për periudhën e dytë rregullative për Furnizuesin me Shërbim Universal, andaj FSHU rezervon të drejtën të aplikoj këto vlera në bazë të dhënave historike, si dhe vlera të pritshme e të justifikuara.

Struktura e dokumentit përbëhet nga shtatë pjesë kryesore, respektivisht:

1. Bilanci i Energjisë Elektrike dhe Blerjet e Energjisë
2. Shpenzimet me pakicë në vitin relevant t
3. Shpenzimet e energjisë me shumicë për nevojat e FSHU-se në vitin relevant t
4. Kostot e bartshme në vitin relevant t
5. Kostot e kapitalit të punës dhe lejimi i borxhit të keq në vitin relevant t
6. Përshtatjet, përkatësisht faktori korrigjues i të hyrave për vitin relevant t
7. Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin relevant t

FSHU mbetet e përkushtuar për bashkëpunim me qëllim të arritjes së konkluzioneve të duhura, të cilat janë në interes të të gjitha palëve të përfshira në sektorin e energjisë.

2. Bilanci i Energjisë Elektrike dhe Blerjet

Çdo vit Furnizuesi me Shërbim Universal parashikon shitjet për konsumatorët e tij për vitin e ardhshëm, duke përdorur informatat historike dhe komponentët e tjerë që ndikojnë në shitjet, siç janë kushtet atmosferike dhe rritja ekonomike (përfshirja e konsumatorëve të rinj, indekset e blerjes së energjisë, GDP, etj.).

Sipas vendimit të ZRRE-së për amendamentin e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut më 28 mars 2019, nga data 1 prill 2020 konsumatorët e kyçur në nivel e tensionit 35 kV, të cilët i përmbushin kushtet e përcaktuara në Ligjin për Energjinë Elektrike, më nuk do të furnizohen nga Furnizuesi me Shërbim Universal. Në këtë kuptim dhe bazuar në informata që posedon FSHU deri në kohën e dorëzimit të këtij aplikimi, FSHU ka përfshirë parashikimin e këtyre konsumatorëve vetëm deri në fund të Marsit 2020.

Shitjet e parashikuara nga FSHU për vitin 2020 janë 4,111 GWh, siç tregohet në tabelën e mëposhtme:

Niveli i tensionit	Jan	Shk	Mars	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Sht	Tet	Nen	Dhj	Total
35 kV	4	4	5	0.60	0.56	0.60	0.65	0.50	0.60	0.56	0.49	0.42	18
10 kV	39	35	39	34	31	33	35	36	34	37	41	49	442
0.4 kV	38	31	37	29	31	30	34	35	30	32	35	41	403
0.4 kV / II	67	57	58	46	47	45	50	55	48	48	56	68	645
Amvisëri	287	231	241	195	197	180	188	194	180	195	219	268	2,574
Ndriçimi Publik	3	3	3	2	2	2	2	2	2	3	3	3	29
Total	**438**	**361**	**383**	**307**	**308**	**290**	**310**	**322**	**294**	**315**	**354**	**430**	**4,111**

Bazuar në shkresën e lëshuar nga ZRRE më 3 dhjetor 2018, KEK-u do të ofrojë kapacitetin e tij me prioritet për FSHU-në, kështu që gjatë parashikimit të bilancit të energjisë FSHU fillimisht do të parashikojë blerjet orë për orë nga KEK-u dhe BRE-të, si dhe blerjet nga importi sa herë që prodhimi vendor është i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat e konsumit të Furnizuesit me Shërbimit Universal.

Bazuar në të dhënat e fundi të pranuara nga KEK gjatë planifikimit të bilancit për vitin 2020, përveç mirëmbajtjeve të rregullta vjetore në njësitë gjeneruese, gjatë vitit 2020 Njësia Gjeneruese B1 do të jetë jashtë funksionit nga data 13 prill deri më 31 dhjetor 2020. Duke pasur parasysh që KEK-Gjenerimi përbën 90% të prodhimit vendor dhe Kosova nuk ka alternative tjera të mjaftueshme për të mbuluar kërkesën e konsumit, mos-operimi i njësisë gjeneruese B1 ka rritur jashtëzakonisht shumë nevojën e importit për Furnizuesin, i cili mbulon rreth 90% të nevojave të veta përmes prodhimit vendor.

Mungesa e energjisë së disponueshme me çmime të volitshme, veçanërisht gjatë sezonit dimëror, kufizimet e mundshme të rrjetit (fytet e ngushta) dhe efekti i çmimeve të importit janë vetëm disa nga problemet e mundshme me të cilat mund të përballemi këtë vit.

FSHU në një shkresë zyrtare ka adresuar këtë çështje tek institucionet relevante, përfshirë edhe ZRRE-në, me qëllim të fillimit të një diskutim midis palëve për të analizuar mundësitë e tejkalimit të ndikimeve të mundshme negative. Megjithatë, deri në kohen e aplikimit për të Hyrat e Lejuara Maksimale të FSHU-së ende nuk është ndërmarr asgjë konkrete.

Në këtë kuptim, bazuar në parashikimet e konsumit dhe kapaciteteve të disponueshme orë për orë të prodhimit vendor të parashikuar në bilancin e energjisë për vitin 2020, FSHU ka paraparë blerjet e energjisë sipas burimit të prodhimit, të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Bilanci Energjetik 2020	**GWh**
Blerjet	**4,111**
KEK Gjenerimi	3,496
Blerjet nga BRE në marrëdhënie kontraktuale me KOSTT	360
Blerjet nga BRE në marrëdhënie kontraktuale me KESCO	48
Importi	207
Konsumi	**4,111**
Mbetje / Deficiti	-

Për sqarim duket të theksohet se edhe nëse sipas bilancit të aprovuar duket se ka energji të mjaftueshme në dispozicion për të mbuluar të gjithë nevojat e konsumit, ajo jo-domosdoshmërish i plotëson nevojat e furnizuesit orë për orë, andaj gjatë parashikimeve orë për orë sipas kapaciteteve mund të vërejmë se ka nevojë për import, e kjo dukuri sidomos është prezentë gjatë orëve të pikut.

3. Kostot me pakicë për vitin 2020

Bazuar në nenin 14 të Rregullës për të hyrat e FSHU-së, kostot e lejuara të shitjes me pakicë që lidhen me furnizimin e konsumatorëve të rregulluar përbëhen nga Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes, zhvlerësimi dhe kostot e tjera që janë jashtë kontrollit të FSHU-së.

Meqenëse, ZRRE nuk ka hapur konsultim publik mbi parametrat hyrëse për periudhën e dytë rregullative për Furnizuesin me Shërbim Universal, FSHU rezervon të drejtën të aplikoj këto vlera në aplikimin e vet derisa ato janë të arsyeshme dhe të justifikuara.

Parashikimi i shpenzimeve operative (OPEX) për vitin 2020 parashikon një rritje prej 2% nga OPEX-i i aprovuar në vitin 2019, për të pasqyruar ndryshimet e reja në sektorin e energjisë, kërkesat qeveritare dhe reflektimin e kostove aktuale.

OPEX i aprovuar për vitin 2019 ishte vazhdim i shpenzimeve operative të vendosura në periudhën e parë rregullative, pa kryer analiza të hollësishme, andaj këto vlera nuk marrin parasysh kostot e rritura të shërbimeve dhe vëllimin e rritur punës. Kështu, FSHU në këtë aplikim ka parashikuar një rritje prej 2% ndaj OPEX-it të aprovuar në vitin 2019, në mënyrë që të pasqyrojë ndryshime të reja në sektorin e energjisë, kërkesat qeveritare dhe pasqyrimin e kostove reale.

Numri i konsumatorëve është rritur nga 470,000 konsumatorë aktivë në vitin 2013, kur aktiviteti i furnizimit është privatizuar, në mbi 600,000 konsumator aktiv, e cila rritje ka ndikuar edhe në rritjen e shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve për këta konsumatorë, por të cilat nuk po reflektohen si të tilla nga Rregullatori tek shpenzimet e lejuara operative. Periudha e parë rregullative përfshinte kostot e pagave të punonjësve të trashëguar nga i licencuari i mëparshëm dhe asnjë kosto tjetër për punonjësit e rinj nuk u lejua gjatë periudhës së parë rregullative. Edhe pse, në rishikimin e fundit të tarifave janë bërë disa përshtatje, FSHU ka ende dallime të mëdha në paga në krahasim me sektorin publik, përderisa ngarkesa e punës është shumë më e lartë dhe ambienti i punës është shumë më stresues. Duke marrë parasysh që ka mospërputhje në paga midis punonjësve tanë dhe punonjësve të tjerë në të njëjtin sektor, FSHU do të dëshironte të pasqyronte përpjekjen dhe ngarkesën e punës së punonjësve të vet, njëherazi edhe t'i motivojë ata më tej duke aplikuar një rritje shtesë në paga, nëse këto kosto do të lejohen nga rregullatori. Në këtë këndvështrim, **FSHU kërkon nga ZRRE që me seriozitet të konsideroj një rritje në linjën e pagave**, e cila duhet të shtohet si kosto shtesë ndaj OPEX-it të kërkuar në këtë aplikim.

Për më tepër, duhet të theksohet se kostot e sigurimit shëndetësor të përfshira në shpenzimet operative në dy vitet e fundit janë rritur për mbi 50%. Duke marrë parasysh rritjen e vazhdueshme të çmimeve të sigurimeve shëndetësore ndër vite, kostot aktuale të lejuara për sigurimin shëndetësor mundësojnë blerjen e një mbulimi bazë të sigurimit shëndetësor. Pranimi i primës aktuale të sigurimit shëndetësor, me një kosto prej 10 € shtesë për punëtor, të cilat përfaqësojnë çmimet aktuale të tregut, të aplikuara edhe nga të licencuarit e tjerë në sektor, do të thotë një kosto

shtesë prej 2,110 € /muaj, e cila shtesë do të ishte shumë e përshtatshme si për kompaninë ashtu edhe për punonjësit duke pasur parasysh që sigurimi shëndetësor jo vetëm që jep një siguri në punë, por është edhe një kërkesë ligjore. Prandaj, ne kërkojmë nga Rregullatori që të marrë parasysh këto kosto gjatë përcaktimit të OPEX-it për vitin 2020.

Për më tepër, duhet të theksohet se edhe kostoja e ofrimit të shërbimeve është rritur gjatë viteve, e cila gjithashtu nuk është reflektuar si e tillë në OPEX-in e aprovuar të vitit 2019. Gjatë vitit 2019 për herë të parë kanë filluar të operojnë edhe konsumatorët prodhues, të cilët kërkojnë ndryshime në sistemet e faturimit dhe jo –vetëm. Deri në fund të vitit 2019 kemi pasur gjithsej 7 konsumatorë të regjistruar si konsumatorë prodhues, të dhënat e të cilëve aktualisht po regjistrohen dhe faturohen manualisht, por e cila metodë nuk është e përshtatshme me rritjen e numrit të këtyre konsumatorëve.

Marrë parasysh që kostot e shitjes me pakicë përfshijnë edhe kostot e zhvlerësimit, FSHU parashikon një rritje të njëjtë prej 2% edhe në kostot e zhvlerësimit nga kostot e miratuara për vitin 2019, duke pasur parasysh ndryshimet në treg dhe përditësimet ligjore, të cilat kërkojnë investime shtesë, veçanërisht në pajisjet e telekomunikimit dhe softuerëve. Prezantimi i konsumatorëve prodhues në treg gjatë vitit 2019 ka paraqitur nevojën per përditësimin e softuerit të pagesave, e cila duhet të reflektohet këtë vit. Përfundimisht duhet theksuar se konform rregullës në fuqi, OPEX i vitit 2020 gjithashtu aplikon edhe përshtatjen e inflacionit për kostot e aprovuara gjatë vitit 2019, si për OPEX ashtu edhe për kostot e zhvlerësimit.

4. Kostot e blerjes së energjisë

Sipas nenit 17 të Rregullës për të Hyrat e FSHU-së, kostot e energjisë lidhur me furnizuesit e rregulluar përbëhen nga:

- Kostoja e energjisë e blerë nga prodhimi vendor (GENCt)
- Kostoja e importit të energjisë (IMPCt)
- Margjina e Blerjeve me Pakicë (RETMt), dhe
- Kostoja neto e jobalancit (IMBCt), të cilave u aplikohet faktorit ndarës i jobalancit (IMBFt)

Formula e mëposhtme tregon zbatimin e këtyre kostove, të cilat FSHU do t'i përdorë më tej në përcaktimin e të hyrave të saj për vitin relevant t:

$$WHPCt = (GENCt + IMPCt + IMBCt * IMBFt) * (1+RETMt)$$

4.1. Kostoja e energjisë së blerë nga prodhimi vendor

Prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë është i dominuar nga dy termocentrale të mëdha që prodhojnë 90% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike në vend, ndërsa pjesa e mbetur, prej rreth 10% të prodhimit të energjisë elektrike mbulohet nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë.

Siç e potencuam me lartë, në planin vjetor të punës për vitin 2020, KEK përveç planit të rregullt të mirëmbajtjes, parasheh që njësia gjeneruese B1 të dalë jashtë funksionimit nga 13 Prilli 2020 deri në fund të vitit, e cila po ndikon jashtëzakonisht shumë në rritjen e kostove që do t'i barten konsumatorëve fundor si e tillë, pa e marrë në konsideratë kërkesën e vazhdueshme të KEK-ut për rritjen e çmimit të tij të shitjes dhe/apo ndryshimet e tjera të mundshme në përcaktimin e kostove të sistemit të energjisë elektrike. Megjithëse nuk është në fushën e këtij aplikimi, duhet të theksohet se pritjet janë që mos-funksionimi i njësisë gjeneruese B1 do të jetë më i gjatë se sa pritet, i përcjellë menjëherë nga mos-operimi i njësisë gjeneruese B2, si faza II e IPA projektit, duke ndikuar kështu në vazhdimin e varësisë nga importi për një periudhë shumë më të gjatë, e cila mbetet shqetësuese veçanërisht gjatë kohës kur kërkesa për konsum është më e lartë.

Kjo jo vetëm që rrit koston e blerjes së energjisë elektrike për konsumatorët fundorë, por rrezikon edhe sigurinë e furnizimit në vend. Mungesa e energjisë së disponueshme me çmime të volitshme në treg, veçanërisht gjatë sezonit të dimrit, kufizimet e mundshme të rrjetit (fytet e ngushta) dhe efekti në çmimet e importit janë disa nga problemet e mundshme me të cilat do të përballemi gjatë këtij viti. FSHU në një letër zyrtare drejtuar institucioneve e ngriti këtë çështje për të filluar një diskutim midis palëve të interesuara, me qellim që të analizohet mundësia e tejkalimit të ndikimeve të mundshme negative, siç është opsioni për të aktivizuar të gjitha njësitë gjeneruese në Kosovën A,

të zvogëlohet numri ose koha e mirëmbajtja në njësi gjeneruese aktive dhe / ose alternativa të tjera të mundshme. Sidoqoftë, asgjë nuk është ndërmarrë deri në kohën e aplikimit të FSHU-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale.

Meqenëse shtojca 4 e Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë Elektrike me shumicë (BSA) mbi çmimet e energjisë elektrike është e zbatueshme deri me 31 Mars 2020, FSHU ka kërkuar nga KEK të ofertoj çmimin e tij për vitin tarifor 2020 (1 prill 2020 – 31 mars 2021) dhe bazuar në shkresën e pranuar më 17 janar 2020, çmimi i propozuar nga KEK-gjenerimi për FSHU-në është 33.3/MWh. Duke marrë parasysh që nuk kishte kohë të mjaftueshme për të negociuar dhe respektivisht për të arritur një marrëveshje, FSHU në këtë aplikim përdori çmimin aktual të KEK-ut. Sidoqoftë, duhet të theksohet se meqenëse KEK dhe FSHU ende nuk kanë arritur një marrëveshje, marrja për bazë e një çmim referent nga ZRRE-ja ndryshe nga ajo që mund të dakordohet me KEK-un, do të vendosë FSHU-në në një pozicion financiar jo shumë të favorshëm në mes të vitit tarifor, nëse KEK nuk pajtohet të shesë energjinë e saj në bazë të atij çmimi referent. Marr parasysh ndikimin e këtyre kostove tek konsumatorët fundor, por edhe tek vet kompania nëse ato nuk aplikohen drejtësisht, dhe me qellim që të shmangim rreziqe financiare apo pa-përballueshmi të çmimeve nga konsumatorët fundor, kërkojmë edhe një herë nga ZRRE të aplikoj të drejtën e tij për të vendosur obligim publik ndaj KEK-gjenerimit.

Përveç KEK gjenerimit, FSHU do të blejë energji elektrike edhe nga BRE-të, e cila duhet të merret me prioritet. Në pajtim me Rregullën mbi Skemën Mbështetëse, të miratuar nga ZRRE në Prill 2017 Gjeneratorët e BRE-ve do të shesin prodhimin e tyre të energjisë elektrike tek Operatori i Tregut (OT) dhe OT do të ndajë të gjitha prodhimet e BRE-ve tek furnizuesit, proporcionalisht me kërkesën e tyre individuale në totalin e konsumit të energjisë elektrike në Kosovë. Megjithatë, disa nga BRE-të e vogla do të mbeten në marrëveshje kontraktuale me FSHU, për shkak të marrëdhënieve kontraktuale të trashëguara gjatë procesit të privatizimit dhe/ose bazuar në udhëzimet e nxjerra nga ZRRE për liberalizimin e tregut.

Për shkak të mungesës së informatave rreth çmimit referent për BRE-të deri në fazën e aplikimit, FSHU për të llogaritur kostot e blerjes së BRE, ka përdor çmimin referent aktual për BRE që kanë marrëveshje kontraktuese me Operatorin e Tregut, përderisa për BRE-të tjera që kanë marrëveshje kontraktuale drejtpërsëdrejti me FSHU, do të përdorë çmimin e pajtuar dhe/ose miratuar nga rregullatori. Por duhet theksuar se çdo ndryshim në çmimin referent të aplikuar për BRE gjatë këtij viti tarifor duhet të pasqyrohet nga ZRRE-ja gjatë llogaritjes së të hyrave të lejuara maksimale për FSHU-në.

4.2. Kostot e Importit të Energjisë

Në përgjithësi, balancimi i energjisë bëhet në bazë të kapacitetit, në baza mujore madje edhe orë për orë, pasi gjenerimi lokal në shumicën e kohës është i mjaftueshëm gjatë orëve jashtë pikut dhe respektivisht importi bëhet në parim të moduluar e jo gjatë ngarkesës bazë (base load). Për qëllime të Bilancit të energjisë, FSHU parashikon ngarkesat në baza javore dhe në bazë të planit të parashikuar të punës së njësive gjeneruese (kapaciteti në dispozicion), parashikon vëllimet e importit, në mënyrë që të balancojë nevojat e tregut dhe mungesën e prodhimit.

Me 29 gusht 2019 KEK dërgoj zyrtarisht planin vjetor të punës për vitin 2020, e cila për shkak të mos-operimit të njësisë gjeneruese B1 nga 1 prilli- 31 dhjetor, ka rritur shumë nevojën e importit gjatë vitit 2020. Bazuar në parashikimin e shitjeve në nivel të shpërndarjes për vitin 2020, nevoja për import pothuajse po dyfishohet si në aspektin energjetik ashtu edhe në të kostove.

Duhet të theksohet se gjithashtu çmimet e importit po tregojnë një trend të lëvizjes se çmimeve te importit, duke e ekspozuar kështu furnizuesin drejtpërsëdrejti ndaj pasigurisë financiare. Parashikimet e çmimeve në tregun e HUPX për vitin 2020, tregojnë një çmim mesatar të moduluar prej 68.3 €/MWh. Marr parasysh këtë trend kërkojmë nga Rregullatori të aplikoj drejt çmimin e importit për vitin 2020.

4.3. Parametrat hyrëse

Vlerat hyrëse janë parametrat kryesorë të përdorur në llogaritjen e të hyrave të rregulluara të Furnizuesit me Shërbime Universal. Bazuar në Nenin 12 të Rregullës së Çmimeve të FSHU, Marzha me Pakicë dhe faktori i ndarës i jo-balancës (i përdorur në formulën e WHPC) konsiderohen si parametra hyrëse. Paragrafi 4 i këtij neni thotë se ndër të tjera këto dy parametra përcaktohen në një periudhë prej tre vitesh.

Meqenëse ZRRE nuk ka hapur procesin e shqyrtimit dhe nuk ka aprovuar parametrat hyrëse për periudhën e dytë rregullative për Furnizuesin me Shërbim Universal, FSHU në këtë aplikim do të përdorë për marzhën e shitjes me pakicë të njëjtën përqindje (3%) që është aplikuar në periudhën e parë rregullative, dhe ngjashëm nuk do të aplikojë asnjë vlerë për faktorin ndarës të jo-balancës, meqenëse përcaktimi i parametrave hyrëse duhet të bëhet ne përputhje me proceset e përcaktuara në Rregullën e Çmimeve të FSHU-së.

4.4. Përcaktimi i Kostove të Blerjes me Shumicë për vitin 2020

Sipas formulës për përcaktimin e Kostos së Blerjes me Shumicë dhënë në rregullën e Çmimeve dhe përshkrimit të kostove si më lartë, kostot totale për mbulimin e parashikimit të konsumit për vitin 2020 janë vlerësuar si 136.3 milion €.

Përshkrimi	GWh	mil€
KEK Gjenerimi	3,495.8	103.1
Importi	207.5	14.2
BRE Prodhimi në marrëveshje kontraktuese me KOSTT	360.5	12.8
BRE Prodhimi në marrëveshje kontraktuese me FSHU	47.5	2.2
Margjina me pakicë		4.0
Totali i Shpenzimeve të Blerjes së Energjisë me Shumicë	**4,111.3**	**136.3**

Kapacitetet energjetike dhe kostot financiare të prezantuara në tabelë janë parashikuar të mbulojnë nevojën e konsumatorëve të furnizuar nga Furnizuesi me shërbim Universal për vitin 2020.

5. Kostot e bartshme për vitin përkatës t

Konform nenit 18 të Rregullës së Çmimeve të FSHU-së, gjatë përcaktimit të MAR-it, FSHU do të mbulojë kostot e mëposhtme:

- Kostot e OT që faturohen nga OT dhe kanë të bëjnë me Konsumatorët e FSHU-së;
- Kostot e OS të cilat faturohen nga OS dhe ndërlidhen me Konsumatorët e FSHU-së;
- Kostot e SHST (TUOS) që faturohen nga OST dhe ndërlidhen me Konsumatorët e FSHU-së;
- Kostot për përdorimin e sistemit të shpërndarjes që faturohen nga OSSh dhe lidhen me Konsumatorët e FSHU-së; dhe
- Pjesa e taksës për Licencës që lidhet me Konsumatorët e FSHU-së

Sidoqoftë, duhet të theksohet se përveç të lartpërmendurave FSHU i paguan OST edhe kostot për Fondin e BRE-ve, i cili do të përfshihet si pjesë e kostove të bartshme.

Tarifa për Licencë llogaritet si një tarifë e paracaktuar nga Rregullatori e shumëzuar me energjinë e pritshme të importit në MWh. Meqë ZRRE nuk ka iniciuar ndonjë proces për të ndryshuar tarifën për licencë, FSHU do të aplikojë të njëjtën tarifë siç ka zbatuar edhe në periudhën e mëparshme rregullative (0.22 € / MWh).

Ndërkohë, meqenëse bazuar në afatet kohore të përcaktuara në Rregullën e Çmimeve të FSHU, si dhe në letrën zyrtare të ZRRE-së për aplikimin e MAR, nuk ka dallime në afatet kohore kur të licencuarit e tjerë paraqesin aplikimet e tyre, FSHU do të përdorë informacionet që janë në dispozicion deri në kohën e dorëzimit të këtij aplikimi, respektivisht do të aplikojë çmimet aktuale në konsumin e parashikuar për kalkulimin e këtyre kostove gjatë kërkesës për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2020. Çdo ndryshim nga ZRRE-ja gjatë përcaktimit të tarifave për OSSH dhe OST duhet të pasqyrohet në MAR-in përfundimtar për Furnizuesin me Shërbim Universal.

6. Kostot e kapitalit punues dhe kompensimi për borxhin e keq në vitin relevant t

Vlera e komponentëve të kostove që do të shpjegohet në këtë seksion llogaritet në bazë të formulave të specifikuara në Rregullën e Çmimeve të FSHU-së. Sidoqoftë, bazuar në Nenin 16 të Rregullës së Çmimeve të FSHU, Rregullatori do të duhet të vendosë kompensimin për Borxh të Keq gjatë përcaktimit të parametrave hyrës. Megjithatë, ashtu siç u shpjeguan më lartë borxhi i keq nuk është përcaktuar nga Rregullatori për këtë Periudhë Rregullative dhe respektivisht FSHU do të aplikoj përqindjen më të arsyeshme dhe të justifikueshme, e cila duhet të konsiderohet nga Rregulaltori gjatë përcaktimit te MAR-it për vitin 2020.

6.1. Kostot e kapitalit punues

Konform nenit 15 Kostot e kapitalit punues llogariten si kosto e financimit të kapitalit punues për FSHU-në shumëzuar me vlerën e lejuar të kapitalit punues. Kjo kosto i mundëson FSHU-së operim të qëndrueshëm dhe kalkulohet sipas formues dhënë në Shtojcën 1 të Rregullës së Çmimeve të FSHU-së:

$$WCLC= (1 / 12) * I_t * (RETR_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t)$$

Në këtë kuptim, duke marrë parasysh komponentët e kostove të paraqitura në seksionet e mëparshme të këtij dokumenti, kostot e pritshme të kapitalit punues për vitin 2020 janë 1.85 milion€.

6.2. Borxhi i keq

Borxhi i keq është një vlerësim dhe nivel i arsyeshëm i borxheve të këqija të shkaktuara tek FSHU gjatë një viti relevant t. ZRRE-ja nuk ka përcaktuar Lejimin për Borxhin e Keq për periudhën e dytë rregullative ashtu siç kërkohet nga Rregulla për të Hyrat e FSHU-së, por gjatë përcaktimit të të hyrave të FSHU-së për 2 vitet e para ka aplikuar lejesën e aplikuar në vitin e fundit të periudhës së parë rregullative.

Edhe pse në 3 vitet e fundit të periudhës së parë Rregullative, Lejimi për Borxhin e keq ishte 4%, duhet të theksohet se një raport i tillë konsideron arkëtimin nga të gjithë konsumatorët që operojnë në tregun e energjisë elektrike. Megjithatë, raportet e arkëtimit per faturimin e aplikuar gjatë vitit relevant t tregojnë se borxhet e këqija aktuale janë mbi 6%. Ky raport është më i theksuar tek shtëpiakët, të cilët përbëjnë mbi 80% të konsumatorëve të furnizuar nga FSHU-ja.

Arkëtimi %	2016	2017	2018	Total
Sipas MAR-it (Përfshirë në MAR)	**92.35%**	**94.75%**	**94.84%**	**94.02%**

Marr parasysh se gjatë vitit 2020 pritet që konsumatorët industrial të kyçur në nivelin 35 kV më nuk do të furnizohen nga FSHU, arkëtimi i të cilëve është 98-99%, FSHU kërkon që në vitin 2020 të zbatohet lejimi prej së paku 5%, për të siguruar vazhdimësi dhe qëndrueshmëri të operimeve ditore të furnizuesit. Vitin aktual 2019, FSHU e ka përmbyll me humbje financiare, e cila pritet të rëndoj gjendjen e furnizuesit edhe më thellë gjatë vitit 2020 kur edhe nevoja për import është rritur. Për më tepër edhe në vitet në vazhdim konform Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut, konsumatorët industrial të kyçur në nivelin e tensionit 10 kV dhe të tjerë konsumatorë komercial gradualisht do të largohen nga FSHU, duke e lënë kështu FSHU-në kryesisht me konsumatorët që tentojnë të vonojnë dhe / ose refuzojnë pagesat e faturave të pranuara.

Për më tepër, marr parasysh se në ligjin e ri nuk lejohet shkyçja e konsumatorëve që ankohen derisa gjykata të marrë vendim të prerë, dhe marr parasysh procedurat burokratike dhe të ngadalta të gjykatave në Kosovë, rastet do të bëhen të pamundura për t'u trajtuar brenda vitit relevant tarifor. Një lejim i borxhit të keq për të paktën 5% do të ofrojë siguri për punën e përditshme të furnizuesit me shërbimi universal dhe për më tepër do të ndihmojë në eliminimin e subvencioneve ndërmjet kategorive ekzistuese. Çdo aplikim më i ulët se 5% do të ekspozojë FSHU drejtpërsëdrejti në rrezik financiar.

7. Përshtatjet dhe faktori korrigjues i të hyrave për vitin relevant t

Gjatë çdo viti tarifor furnizuesi parashikon kostot e tij të cilat aprovohen nga Rregullatori. Megjithatë, gjatë vitit aktual ekzistojnë dallime në mes të kostove të lejuara dhe aktuale, prandaj përmes një faktori korrigjues këto kosto përshtaten duke reflektuar diferencën ndërmjet kostove të lejuara dhe atyre aktuale.

Në pajtim me Rregullën për të Hyrat e Lejuara Maksimale është bërë korrigjimi i të hyrave të vitit 2019, respektivisht FSHU ka llogaritur MAR-in aktual dhe te hyrat e realizuara gjatë vitit 2019. Sipas kalkulimeve faktori korrigjues ka rezultuar të jetë (9.6) milion € e cila është përshtatur në MAR-in e vitit 2020. Duhet theksuar se ndryshimi më i madh i MAR-it të përcaktuar gjatë vitit 2019 dhe atij aktual është si rezultat i rritjes së çmimit te OST-së, të cilat për shkak se kanë hyre në fuqi nga prilli i vitit 2020 kanë krijuar dallime. Njëkohësisht edhe rritja e volumeve të shitjes ndaj atyre të parashikuara ka rritur kostot aktuale të sistemit krahasuar me ato të aprovuara.

Përshkrimi	mil €
MAR-i i Aprovuar	248.82
MAR-i Aktual	245.33
Shitjet aktuale	254.29
It	7.49%
Faktori korrigjues i të hyrave (ADJ_t)	(9.63)

Në periudhën e mëparshme rregullative, ZRRE ka rritur të hyrat për shumën totale të rikthimit të humbjeve. FSHU vazhdimisht ka kundërshtuar këtë qasje duke treguar se jo e gjitha energjia e faturuar si 'rikthimi i humbjeve' inkasohet nga konsumatorët, për faktin se:

- Konsumatorët mund të paraqesin ankesë në radhë të parë në ZRrE, dhe më vonë edhe në Gjykatë, dhe si e tillë jo e tërë energjia e faturuar fillimisht lejohet të faturohet pas vendimeve të tyre, respektivisht arkëtimi i tyre është procedurë e zgjatur dhe e diskutueshme
- Praktika po tregon se vetëm një pjesë e kësaj vlere mblidhet në praktikë, afërsisht rreth 20% e energjisë së faturuar në emër të rikthimit të humbjeve

Prandaj FSHU në këtë aplikim ka aplikuar vetëm 20% të faturimit në emër të rikthimit të humbjeve dhe kërkon nga ZRRE që gjithashtu të njoh dhe të aplikoj vetëm 20% të faturimit në emër të rikthimit të humbjeve. OSSH paguan FSHU-në vetëm për shumën e marrë nga konsumatorët fundorë dhe nëse ZRRE vazhdon të aplikojë gjithë shumën e faturuar si të hyra nga rikthimi i humbjeve, atëherë FSHU do të ketë nevojë për lejim më të lartë për borxhin e keq për të arkëtueshmet që lidhen me rikthimin e humbjeve.

8. Përcaktimi i MAR për vitin relevant t

Të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për vitin 2020 do të mbulohen nga tarifat e rregulluara të shitjes me pakicë dhe përfshijnë vetëm kostot e konsumatorëve që do të furnizohen nga Furnizuesi me Shërbim Universal.

FSHU ka konsideruar se konsumatorët e kualifikuar të kyçur në nivelin 35 kV do të operojnë në tregun e hapur që nga prilli i vitit 2020 sipas udhëzimeve të ZRRE-së, prandaj nuk janë llogaritur kostot për këta konsumatorë nga prilli e tutje. Në mënyrë të ngjashme, nuk do të llogariten të hyra gjatë përcaktimit të të Hyrave për vitin 2020.

Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të kërkesës për të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU-në për vitin 2020, pasi të dihen të gjitha elementet e kostove, siç është shpjeguar në kapitujt e mëparshëm dhe konform shprehjes për llogaritjen e Të Hyrave të Lejuara Maksimale në vitin relevant:

$$MAR_t = (RETR_t + WCLC_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t + KREV_t) / (1-BDTA_t)$$

MAR-i i FSHU-së për vitin 2020	**mil €**
It	7.49%
Kostot e lejuara me pakicë	**6.36**
OPMCt	6.25
DEPCt	0.11
Kostot e bartshme (PSTCt)	**153.8**
Kostot e OST	30.32
Kostot e OSSH	110.33
Fondi BRE	13.15
Kostot e kapitalit punues (WCLCt)	**1.85**
Kostot e energjisë me shumicë (WHPC)	**136.31**
WHPC	132.34
Margjina me pakicë	3.97
Taksa për licencë	**0.05**
Faktori i përshtatjeve të të hyrave (ADJ)	**(9.63)**
BDTA	5.0%
FSHU MAR	**303.94**

Përcaktuesit e faturimit për vitin 2020 janë bazuar në vëllimet e shitjeve të parashikuara në Bilancin e Energjisë. Me aplikimin e tarifave aktuale mbi përcaktuesit e faturimit të parashikuar për vitin 2020, priten të hyra të faturuara në vlerë prej € 275.91 mil.

FSHU mbetet i angazhuar për bashkëpunim me qëllim të arritjes së konkluzioneve të duhura, të cilat janë në interesin e të gjithë palëve të përfshira në sektorin e energjisë.